

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME ILAZ PIREVËN

Lupç i Poshtëm | Data: 2 Gusht, 2023

Kohëzgjatja: 122 minuta

Të pranishëm:

- Ilaz Pireva (i Intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Latra Demaçi (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Ilaz, nëse mundeni fillimisht m'u prezantu, me na tregu diçka për prejardhjen e juj, çfarë familje jeni?

Ilaz Pireva: Si edhe për shumë familje të tjera, nuk mundemi të lëshohemi thellë në lidhje me prejardhjen tonë. Nuk dijmë shumë. Mbiemrin Pireva e kemi sipas toponimit të këtij vendi. Ky ekziston dikund, sipas do hartave, 1420 ni Pirovo, Pirevë. Kemi qenë dy familje. Osh't blerë atëherë në kohën e Perandorisë Osmane, osht' ble kjo pjesë prej pronarëve t'mëdhej kur janë bo disa reforma. Njo dy familje e kena ble këtë vend. Familja tjetër Hysi, dy hise. Na kena pasë, familja e katragjyshit tonë ni hise domethonë.

Familja tjetër e ka pasë ni Beqir Pireva, tash po i them, në kohën e Perandorisë Osmane 1850 e diçka osht' mobilizue dhe osht' dërgue në Luftën Ruso-Turke. Ai kthehet në shtëpi mbas 12 vjetësh. Fati i tij pastaj përfundon në kohën kur Serbia okupon Kosovën, 1912-ten. I marrin pesë burra të Lupçit dhe i kanë mbyttë, osht' ni lagje me thanë te Podujeva, Surkish. Atje ju kanë thanë do pusa të Surkishit, atje i kanë mbyttë shumë njerëz, domethonë me hyrjen e Serbisë këtu në Kosovë.

Vllavi i babgjyshit tim osht' mobilizue 1912-ten, mobilizimi që ka bo Hasan Prishtina dhe Isa Boletini. Është shkuruar Shkupi, dihet deri në Shkup. Masanej kanë vazhdu rrugëtimin. Fati i tyne nuk dihet ma. Sikur edhe sot që nuk kemi njerëz që ju dihen, që i dihen ku kanë mbetë, t'pagjeturit osht' fjala. Edhe n'atë periudhë ka pasë njerëz që nuk osht' ditë ku kanë mbetur. Do të thotë na ka... fati i këtij populli nuk osht' vetëm i sotit kështu i ranë, po domethonë edhe shumë, shumë ma herët.

Pastaj, kanë pasë edhe telashe të tjera si familje. Osht' interesant tash për babgjyshin tim ka pasë ni odë që ka qenë odë e njohur, tash osht' prishë si objekt. Nuk ka qenë si objekt kumeditë çfare, si ka oda t'mira. E ka pasë. Po pse e ka bo me atë emër aq t'njoftun, domethonë, ka qenë personi. Tani jom bind që objekti s'pe bonte, themi n'atë kohë për odat, po ishte njeriu që po e bonte t'madh, t'madhe odën. Dihet edhe me okupimin... vitet e '40-ta pastaj kur ndodh ajo çka ndodh në Luftën e Dytë Botërore plot njerëz mobilizohen në emër të formimit edhe të ushtrisë shqiptare.

Secila shtëpi, këtë pjesë s'paku mund t'flas, qysh më është thanë, ka qenë e detyrune me dhanë ni mashkull, ni burrë. Fati i ka ra babës tim. Mbas ni kohe pastaj kanë rrjedhë ato si kanë rrjedhë. Këta bile kanë ikë, ta quj tash, në nifar' mënyre tash në zhargonin ushtarak, dezertue. Në ni aspekt ne dy shpitë kemi qenë pak nën... të atij pushtetit mas '45-tes. Unë jom i '45-tes. Në emër të tepricave, *višak* i kanë thanë serbisht, na i kanë marrë edhe miellin në magje.

Baba u detyru... tokë kena pasë mjaft, po na kanë marrë krejt në emër se gjoja ju po sabotoni, ju keni mjaft. Edhe jo vetëm na, po plot familje që kanë qenë ma t'pasura. Osht' dashtë t'shkoj në Vojvodinë t'blej misër, dhe jo ky misri i mirë që hahet njerëzit e asi po atyne bagëtive. Ashtu faktikisht e kemi ni atë mungesë të bukës. Na e kena pasë ni zojë shtëpie, na thoshte, "Nisja me Bismilah se ngiheni. Po s'e nisët me Bismilah", bile ajo e ka pasë, vllaun e ka pasë hoxhë, "po s'ia nisët me Bismilah, me ju qit' bukë kumeditë sa ju nuk ngiheni". Na osht' dashtë me Bismilah m'u ngi.

Faktikisht, domethonë, si fëmi e kom përjetu edhe atë periudhë shumë të randë ku sofrat tona kanë qenë të zbrazëta. Pastaj kam nisë filloren këtu në Lupç në '52-shin. Janë hapë dy paralele, klasa e pestë dhe e gjashtë. Osht' ndërto edhe ni objekt i ri i shkollës. Mas dy vjete e kanë mbyllë shkollën. Bile vlen t'përmendet, n'atë shkollë, klasën e pestë e të gjashtë që e kanë mbarue janë shpërnda. Përpos Zeqir Gërvallës, Vehbi Kikaj poetit, Sabit Retkocerit dhe ni Ilmi Kikës. Ata e kanë vazhdu klasën e pestë dhe të gjashtë me ni fshat tjetër të komunës së Prishtinës. Domethonë, prej Podujevës e knej asni shkollë e plotë fillore s'ka qenë.

Anita Susuri: E shkolla juj pse osht' mbyllë?

Ilaz Pireva: Kanë marrë menihërë vendim m'i mbyllë shkollat shqipe, domethonë, aty ka qenë arsyeja. E kanë mbajtë ni shkollë fillore diku mbi Podujevë, ku ka pasë ma shumë serb. Përndryshe vetëm Podujeva në krejt Llapin e ka pasë ni shkollë tetë klasëshe. Unë tani e kam kry dy vjet në Bardhosh, atëherë u kanë Jugoviq. Asni shtëpi s'ka qenë shqiptare, krejt kanë qenë kolonist. Kanë mbajtë atje tri vjet, tani na kanë thy prap në Besi, në fshatin Besi. Tani në Besi e kam krye klasën e shtatë edhe të tetë.

Aty kom pasë fatin ndër të tjera ta kom profesor të gjuhës shqipe të madhin akademikun Ejup Statovcin. Në '58-ten kom pasë rastin të blejmë librin, veçsa ka dalë prej botimit, të Adem Demaçit "Gjarpërinjtë e gjakut". E ka pru në shitje ni Zeqir Kapiti, vëllau i tij kishte qenë i burgosur, Sabit Kapiti. Ata e kena pasë mësues. Na e kena pasë hall, sepse ishim të komunës së Podujevës, dhe naj ngatërresë me serbët që u ba, neve na kanë kërcënue se, "Ju s'jeni të ksaj komune dhe ju largojmë krejtësisht prej shkollës". Megjithatë janë përballu këto.

Megjithëse si fëmi këtu ka ardhë treni në orën 05:00 t'mëngjesit për punëtor ka qenë ai tren prej Podujeve në Prishtinë. Në ora 05:15 kemi mrrri në Bardhosh. Tash merrni me mend, dimri, fëmi 12-13 vjeçar me mrrri në 05:15, merrni me mend çfarë veshmbathje kemi pasë, s'mund ta imagjinoni. Me bukë t'kollomojt. Kemi qenë nja 20 vet të Llapit atje që kemi udhëtue. Shkolla hapej në orën 08:00.

Treni vinte pastaj në orën 04:00. Dhe tash fëmija, po thom, prej orës 04:00 t'mëngjesit me u çue, m'u përgatit me shkue, po ia kemi dalë. Në krejt këto se kaniherë mund t'thoni ju, çfarë fminije e keni përjetu, ku keni gjetë naj gzim ose diçka n'krejt n'këto rrethana, n'këto kushte. Megjithatë fëmija po gjendje, fëmija po gjente t'knaqej me diçka. Kom mbaru shkollën e mesme tani në Prishtinë. Jemi njoftë tani me shokë, domethonë, me Osman Dumoshin, Afrim Loxhën i ndjerë. Tash të ndjerë te dytë ma, Xheladin Rekalinë, Skender Muçollin dhe plot të tjerë.

Në '64-shin jena bo grup, jena bo pjesë e grupit të të rinjëve në grupin e Adem Demaçit. Disa shokë tanë kanë ra, i kanë majtë kah ni muj ditë burg. Unë, Osmon Dumoshi dhe Avdi Pireva nuk kemi ra n'burg. Pastaj, kemi fillue, ishte që ne rriteshim me atë frymën e asaj që ishim pjesë e, edhe pse s'kishim ra në burg. Erdhi '66-shi ra ajo klika e Rankoviqit¹ që i kanë thanë. Gjoja si krejt strumbullari i atyne t'kqijave ka qenë ai. Megjithatë pak morëm frymë.

Anita Susuri: Deshta edhe me ju pytë, a ju kujtohet diçka prej kur kohës së Rankoviqit, mbledhjes së armëve që ka qenë? A ka pasë në vendin e ju?

Ilaz Pireva: Po, po. M'kujtohet si fëmi kemi qenë n'shkollë mbasdite, ka qenë dimër i fortë. Na kanë lirue pa mbaru mësimi, na ka thanë, "Shkoni në shtëpia se kemi ni mbledhje me qytetarët e katunit të Lupçit". Na si fëmi, "Shkoni n'shtëpi", si çdo fëmi tjetër, as nuk kemi ditë për çka osht' fjala. Masanej kemi marrë vesh n'shtëpi kur kemi ardhë, ka pasë tortura t'randa. Si pasojë e atyne torturave baba jo po babgjyshi i Ylfete Humolli ka vdekë, si pasojë e torturave. Edhe disa të tjerë masanej kur kemi dëgju prej prindërve, se t'vegjël kemi qenë na. Kemi pa pasojat që i kanë pasë ata njerëz prej atyne torturave shumë t'randa.

Erdhi, po them, ai '66 krijohet prap ni atmosferë pak ma e lehtë. Pritjet janë se do t'jetë ma mirë dhe do t'përgjigjen ata që kishin kriju atë gjendje. T'u mendu tash që një njeri po ai ishte ni sistem. S'ishte çashtja e një njeriu. Në '67-ten janë djegë Kino Rinia dhe ni separacion i thëngjillit në Hade ka qenë atje në shenjë të asaj çka kishte ndodhë. Domethonë ishin forcat që kishin mbetë të Rankoviqit, të atij sistemi. Për fat t'keq, janë gjetë do njerëz tanë që kanë kry ato vepra. Bile ne tani kemi shku kemi ndjekë ato procese që janë mbajtë në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës.

Bile ka qenë baba i ni Ilir Tolaj ka qenë prokuror. Ndërsa, gjykatës ni Tadej Rodiqi. I patën dënu ata për ato vepra që i kishin bo t'cilat kishin qenë të sigurimit të shtetit të atyne që kishin bo zullume në popull. Nuk di çka ka ndodhë pastaj me ata njerëz sa kanë majt burg. Po domethonë që atëherë dojshim m'i ditë pak rrjedhat e jetës. Ka ardhë '68-shi ka qenë ni vit jubilar me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Për herë t'parë na tash takojmë njerëz nga Shqipëria. N'krye me akademikun

¹ Aleksandar Rankoviq (1909-1983) ishte hero partizan serb i cili mori pozitën e Ministrit të Punëve të Brendshme në Jugosllavi dhe ishte udhëheqës i Inteligjencës Ushtarake pas Luftës së Dytë Botërore. Ai krijoi një sistem terrori në Kosovë, pasi që e konsideronte atë si rrezik për sigurinë e Jugosllavisë nga 1945-1966, kur dhe ai u largua nga Lidhja Komuniste.

Aleks Buda, Bujar Hoxha, Dhorka Dharmo, Mediha Shyteriqi, Thoma Muzarku dhe disa të tjerë që merrnin pjesë. Kishte edhe nga Europa që merrnin pjesë në atë simpozium me rastin e 500 vjetorit.

Për neve ishte mbi t'gjitha ajo që takonim njerëzit për herë t'parë të Shqipërisë. Bile rinia vazhdimisht kur mbaronin ato seanca... osht', ai simpozium osht' mbajtë në sallën sot ku osht' Kuvendi i Kosovës, në atë sallë osht' mbajtë. Bile na me shumë vështirësi kemi përbirue me shku me i ndëgjue. Se nuk na lejonin...

Anita Susuri: A ju kujtohet çka ka pasë në atë simpozium?

Ilaz Pireva: Po për jetën dhe vdekjen e Skënderbeut, domethonë, për veprat e tij. Bile në fund kur ka përfunduar ai simpozium ishte maji i '68-tes. Osht' për nderë të mysafirëve osht' organizu ni mbramje me Ansamblin Shota. Kanë shku, nejtse, na si kureshtar na s'kena mujt me hy. Në teatrin osht' mbajtë, Teatrin atëherë Krahinor. Jemi sjellë aty kah shkallët e teatrit. Do fëmi kanë provu me hy s'i kanë lanë i kanë ndjekë policia dhe i kanë rraf.

Unë kom qëllu rastësisht aty, qysh ia kom kap ni polici atë pendrekun nuk e di, ai e kish pasë t'lidhun për dore {te kyçi i dorës}. E kom ngre pa vetëdije shkallëve teposhtë. Kur kom ra atje poshtë m'u kanë gju disa civilë tani, të sigurimit ishte fjala. Po kom shpëtue. Domethonë rrehën e parë e kom hongër aty për fëmitë. Se kaniherë m'thojshin diçka këtu kur kom ardhë në Podujevë, për fëmitë, "Amani me fëmi mos më luani, me tana tjerat boni çka t'doni lojna me fëmi mosni".

Po në atë vit, 22-23 prill osht' mbajtë konsulta gjuhësore në Fakultetin Filozofik dhe u miratua që gjuha shqipe, gjuha letrare shqipe të përdorej edhe në Kosovë se ishte në fazën ende jo të përfunduar të atij procesi. U vendos që dhe në shkolla dhe në administratë t'fillohet meniherë me gjuhën letrare. Na ashtu si t'ri si entuziast si ishim, mos me thanë u betum veç, "Na prej ktij çasti kemi me fillue vetëm gjuhën letrare ta flasim". Meqenëse ma vonë e kom pa që...

Bile e kemi pasë ni Sadri Fetiu profesor i gjuhës shqipe në teknik, po e pësim, "Për sa do ta përvetësojmë gjuhën?" Tha, "100 vjet", "U profesor 100 vjet", "Të flitet", tha, "osht' pak 100 vjetëshi, të shkruhet", tha, "ka m'u përvetësue nëse kemi dëshirë dhe vullnet ka m'u përvetësu shpejt. Po t'flitet", tha, "duhet ni 100 vjetësh". Konsideronim edhe sot konsideroj si ni e arritur e madhe mas Kongresit të Alfabetit 1908-shit në Manastir. Manastirin t'cilin e kena harrue. Që po ju thom mos më shkoni në Durrës po merrne rrugën edhe kah Manastiri, shkoni atje, shihni atë muze e ata njerëz. Kanë nevojë për neve. Durrësi s'ka nevojë për neve.

Pastaj, fillun debatet në kuadër të Lidhjes Socialiste që thashë për avancimin e statusit të krahinës socialiste, bile atëherë s'ka qenë socialiste, Krahinës së Kosovës. Atëherë u kanë Kosova dhe Metohi. Se na nuk kena pasë staus t'njejtë me Vojvodinën, ata kanë qenë ma t'avancun, na kemi qenë serbisht i thojnë *oblast* shqip i bjen regjion. Domethonë s'ke qenë ende krahinë. Fillun debatet dhe ne i ndiqnim

ato përpqishim me kuptue çka po kërkojnë, flitnin njerëzit ma të dijës që i kishim. Përpqeshim tani ne fjalët e tyne...

Ishte që të bohet avancimi i statusit apo të ngritet statusi i krahinës në nivel me të tjerët në Jugosllavi. Kjo dikun ka gushti, osht' ndërpre ai debat që u ba. Relativisht i lirë ka qenë. Rilindja e vetmja gazetë i përcjellte ato debate dhe ne përmes Rilindjes mësonim çka. Megjithëse ishim n'fillim që nuk dinim fort çka po donim, nuk kishim fort njohuri. Mos harroni '68-tshi ka qenë ni vit i vlimeve në krejt Europën. Ata kanë pasë kërkesat e tjera. Bile edhe sot e kësaj dite pak të paqarta janë çka ka...

Bile na kena pasë që ju thashë kemi qenë student të Universitetit të Beogradit, na kanë bo nifar' oferte domethonë, se edhe në Beograd ka pasë demonstrata. Kemi thonë, "Jo nuk marrim pjesë në ato", se e dishim se edhe atëherë do të thotë qita Dobrica Qosiqat² edhe atëherë ka qenë se mbas '68-tshit fillun, prej asaj përplasjes që patën me atë Pleumin e Brijoneve³ fillun kapak t'çojnë krye. Po këta njerëzit sikur ni Dobrica Qosiq e disa të tjerë. Tham, "Jo".

Kur u mbyll procesi i debateve për avancimin e statutit të krahinës u mur' ni vendim, thojshin atëherë në Gërmi bile që kjo punë u kry, s'shkohet ma tutje. Atëherë na tham, "E tash osht' fjala jonë", dhe kemi nisë t'bisedojmë. Kemi bo përpjekje që t'konsultohemi me njerëzit që i kemi pasë ma të dijës për kohën, me profesorët...

Anita Susuri: Po ju ndërprej po po më intereson fillimisht si jeni bo ju ky grup me Osman Dumoshin? Keni qenë shoqni apo si?

Ilaz Pireva: Po na ishim t'organizun qysh në '64-shin. N'shkollë kemi qenë bashkë.

Anita Susuri: N'shkollë keni qenë bashkë?

Ilaz Pireva: Po, n'shkollë kemi qenë bashkë. Po tani edhe kemi vazhdu atë jetën se në Shkollën Teknike kemi qenë unë, Osman Dumoshi, ka qenë Skender Muçolli, ka qenë Afrim Loxha, ka qenë Xheladin Rekalii. Bile tash unë boj hajgare se Shkolla Normale ka qenë atëherë qendër ku faktikisht ka pri për shumë çështje tonat, edhe gjimnazi. Po teknika veçsa u pat' hapë në Prishtinë që na bile kena pësu shumë n'atë shkollë. Na kanë kosit.

² Dobrica Qosiq (serbisht: *Dobrica Ćosić*; 29 dhjetor 1921 - 18 maj 2014) ishte një politikan, shkrimtar dhe teoricien politik jugosllav dhe serb.

³ Plenumi i Brioneve është emri i seancës së katërt plenare të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë (KQ LKJ), mbajtur më 1 korrik 1966, në hotelin "Istra" në ishullin Brion. Në këtë seancë, Aleksandar Ranković, ish-nënkryetar i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe sekretar i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, një nga tre njerëzit më të rëndësishëm në vend, u shkarkua nga të gjitha funksionet e shtetet dhe pozicionet partiake.

Ma shumë kena pasë landë në serbisht sesa shqip. Sa për adet naj gjuhë shqipe, naj diçka asi. Përndryshe ato landët profesionale të teknikës tek-tuk ndonjë se i kena pasë serbisht. ‘68-tshi tregoj që Shkolla Teknike u bo tash qendra kryesore... t’u nisë tani edhe prej dëshmori i parë i ‘68-tes ishte nga Shkolla Teknike, nxanës i shkollës teknike, Murat Mehmeti. Fillum na tash t’mendojmë çka duhet t’bohet tash.

Ndoshta mu ajo fryma që ishte në krejt Europën demonstrata, demonstrata edhe na tham, “Do t’organizojmë demonstrata me kërkesat”, që tash ato që u bisedojshin, siç thashë ma herët, ishte avancim i atij statusi. Mirëpo na ishim të organizum, edhe pse s’ishim n’burg, n’grupin e Adem Demaçit. Adem Demaçi në programin e tij e kishte bashkimin e trojeve shqiptare. Tash a të marrim këto kërkesa t’cilat ishin paksa jo fort të artikulune apo të mbesim n’ato kërkesat ku kemi qenë t’organizun në grupin e Adem Demaçit.

Tash ndjem përgjegjësi që kush jemi na të ndrojmë programin e një Adem Demaçi. Tham, “Jo, ne dalim me kërkesën, duam vetëvendosje, dhe ato të tjerat”, që do t’duhej t’ishin në atë frymë. Unë për veti kom marrë pjesë n’disa tubime ku flitej, ku n’kuadër të Lidhjes Socialiste zhvilloheshin këto debate. Ende do të thotë s’kishim mrrri atë pjekurinë n’mënyrë të duhur të artikuluar ato kërkesa në ato debate. Bile përmendshin, “Jo ta kemi statusin e ktyne shteteve baltike”, që kanë qenë atëherë në kuadër të Bashkimit Sovjetik, jo të asaj, jo të asaj. Po nuk kishim njohuri.

U përcaktum domethonë t’dalim me... derisa kishim edhe dron a do të bojmë më keq në qoftëse organizojmë demostrata mos po prishim... se atëherë filloj, ni e vërtetë osht’ rigjistrimi i studentëve filloj t’bohet sipas numrit, sipas përqindjes së popullsisë. Atëherë konsideroj që kishim 75% ishim shqiptarë, 25% të tjerë. U mor’ vendimi që n’fakultete, se atëherë kom qenë bile student i Fakultetit të Lartë të Shkollës Teknike. Kom qenë edhe anëtarë i asaj kryesie. Kryetari bashkëvendasi juj ka qenë [i drejtohet bashkëbisedueses], Eshref Ademi, e kom pasë asistent të matematikës, ishte kryetari ai që vendoste për konkursin.

Unë u çova thashë, “Profesor, duhet 75% të jenë shqiptarë 25 të tjerë”, u çun do profesor serb reagun keq. Bile njëni prej tyne e lëshoj edhe mbledhjen. Ndodhi sikur ndodhë kaniherë në filma bjen telefoni, thrasin prej krahinës atëherë, prej sektorit të arsimit. Thonë, “A e keni shpallë konkursin ende?” Thotë, “Jo”. Dhe nejse, t’u bisedu asi e mbyllë telefonin. Thotë, “Kom kërkesë, atë që tha edhe studenti që duhet t’i përmbahemi kriterit 75 me 25”. Tash fillun t’kërkojnë kuadra se s’ka pasë kuadra udhëheqëse, drejtor e këto. Fillun t’kërkonin kuadra po s’kishe kuadra që i plotësonin ato kriteret sipas tyre, se ishte mangësi.

Mos harroni ‘68-shin nja 670 vet i kena pasë me diploma t’fakultetit, Kosova. Universiteti i Shkupit prodhonte nga 1000 të diplomuar në vit. Prandaj doli ajo kërkesa, “Duam universitet”. Zhvillum debate nëpër teren, u konsultojshim me njerëz që na merrte mendja që nuk do t’i ngarkojmë edhe t’i ruajmë. Doli kërkesa që do t’organizojmë demostrata me 27 nëntor. Pse 27-shin? Se niherë mendum me 28 po

me 28 studentët shkojnë nëpër shtëpija t'veta dhe nuk ka student. Pra, t'shkojmë ni ditë përpara, ajo ka qenë arsyeja.

Këtu m'del kaniherë ni shtrembërim edhe n'pllaka ku shkruhet për '68-tshin thotë, "Demonstratat bënë këtë, këtë, këtë dhe flamurin". Flamuri ka qenë i lirim. Në tetor të '68-tes osht' marrë vendim të lirohet flamuri për përdorim. Po nuk ka qenë ai statusi i tij se osht' mendue që osht' veprim i natyrshëm, nuk shkon përnihërë... gjoja ti mund ta kesh flamurin n'shpi, mund ta qitsh për dasma po në institucione ende nuk e kishte marrë atë të drejtë të valoj.

Mirëpo në demonstrata kemi dalë me flamur kombëtarë t'cilët i ka prodhë fabrika e pëlhurave, atëherë bile osht' kujtë "Napredak" e Gjakovës. S'ka qenë fort ajo ngjyra e kuqe, ka qenë pak ma e zbehtë. Po ishte flamur shqiptar me atë yllin mbas, dihet ma kur osht' vendosë. Po do t'thotë jo me shkru atje në pllaka ku përkujtohet '68-tshi që u liru flamuri. Jo, demonstratat s'e kanë liru. Flamuri ka qenë, ka valu në demonstrata. Këtu osht' ajo që po them unë shpesh herë po i ngatërrojnë kah pak senet, dikush me qëlim e dikush pa qëlim.

U bon ato edhe u dënuan kush ni fjalë t'ranë s'na ka thanë gjatë hetimeve. Mbajtën dënimet. Filloj tani t'bisedohet edhe për ndërrime kushtetuese, se bile n'atë kohë u bo ndryshimi i disa amandamenteve. Ishte ni aksion i të rejave, vitet e '70-ta për shkollimin e femnës shqiptare. Domethonë lindi ni kërkesë brenda vet femnes shqiptare që ato ta marrin rolin edhe të bëjnë që t'përshpejtohet emancipimi i saj. Ishte pak ni frymëmarrje ma e lehtë në çdo aspekt.

Serbët fillun t'i shesin pronat, serbët filluan ngadalë, ata që kishin ardhë prej Serbisë me kah katër klasë fillore... se tani u bo e detyruar dy gjuhësia, domethonë, për serbin duhej ta msonin edhe gjuhën shqipe. Ishte fjala për në administratë. Ata jo që, se osht' interesant, qaq e kanë injorë edhe kta në Kosovë që kanë qenë bile në Prishtinë ma lehtë, ma me dëshirë kanë dashtë t'flasin turqisht sesa shqip. Ishte ajo do të thotë, edhe një për ata që nuk mund t'pajtohen me ni lloj barazie dhe fillun dal nga dalë të tërhiqeshin.

Fillun pronat t'i shitshin, fillun t'ju ngritej çmimi atyne pronave të tyne. Se i kishin marrë si i kishin marrë si kolonist, se pak ka pasë kështu, në gjuhën tonë thojnë raje. Raje janë ata që janë kanë edhe pak gjatë kohës së Turqisë se pjesa dërrmuese kanë ardhë mbas viteve të '20-ta domethonë. Si kolonist, u mur' vesh. Erdh '74-shi, u miratu ajo kushtetutë. Pak po m'duket ju dha një rëndësi ma tepër sesa që duhej dhe që e vërtetoj atë tani ishin ato ngjarjet e mëvonshme që ndodhën.

Pjesa e Dytë

Ilaz Pireva: '75-shin, m'u nda ni proces t'paparë n'krye me Adem Demaçin.

Anita Susuri: Para se t'flasim për këtë pjesë që osht' shumë me rëndësi po du pak m'u kthy edhe te '68-ta, me na tregu pak ma shumë për demonstratën edhe organizimin pasi që keni qenë pjesë e atij grupi t'vogël që edhe keni shkru parollat. Po m'intereson edhe organizimi po edhe ajo ditë qysh osht' dukë? Sa ka pasë pjesëmarrje? Si osht' sjellë policia? Të gjitha këto.

Ilaz Pireva: Unë thashë që ne ishim n'fillim kemi qenë ata që kemi qenë pjesë e grupit të Adem Demaçit. Po tani edhe gjatë shkollimit kemi qenë në valë të njejta në shumë aspekte. Tani në '68-tshin kemi bisedu, kemi qenë kështu t'pandashëm dhe dalë nga dalë tani e kemi zgjeru edhe rrethin. Se edhe ma herët kemi qenë shokë. Po tani që t'bohen pjesë për organizimin e atij grupi, ajo ka ndodhë tani n'verën e '68-tes, domethonë, gushtin.

Se na me ni mënyrë ishim shokë që pos gjumi na ka nda. Me ide të njejta, me pikëpamje të njejta. Dhe tani kur mas shumë debateve që kemi ba si grup atëherë ai grup osht' përcaktu në ni grup të njerëzve që na ka marrë mendja që kanë edhe aftësi organizative. N'fund kemi mbajttë nja tri takime me përcaktu edhe programin e atyne demonstratave. Prej do të thotë parollave n'mënyrës se qysh ditën krejt atë skenarin pa letër, se me shkru s'kena guxoftë (qeshë), osht' dashtë me mbajttë mend...

Anita Susuri: Që mos me ua nxon juve.

Ilaz Pireva: Po se unë e kom pasë atë mangësi, kurgjo s'kom lonë t'shkrune as s'kom mbajttë ditar as kurgjo edhe sot e kësaj dite pritoj me shkru. Kemi heq disa dilema. Mos po bojmi ma shumë dom, po përpiqemi për t'mirë po mos po bojme ma tepër dom çështjes. Kena marrë pajtimin e shumë njerëzve që, "Veç po na dhimen se ideja është e mirë, qëllimi osht' i mirë. Çdo send vetëm përgatituni edhe për burgje".

Ato... bile para se për burgjet na jena përgatitë që sikur ndodhi me Murat Mehmetin edhe me mbetë aty. Se gjithë duhet me mendu atë ma t'randën që mund t'ndodhë e tani çka t'del masanej ajo osht' çashtje tjetër. U përcaktum, siç ju thashë, për 27-tshin që i kishim ende studentët këtu. U morëm vesh që edhe nëpër ndërmarrje t'mëdha ku ka punëtor siç ishte Kombinati, siç ishte "Ramiz Sadiku", siç ishin disa të tjera të kemi njerëz dhe t'i bajmë me dije. Po në momentet e fundit, se nuk guxojsim, se thojshim po shplohemi dhe, dhe pastaj do... demonstratat nuk do t'mund të mbahen.

Bile po kthehem në ni që ka qenë fat i yni, na kemi dashtë të organizojmë edhe ni demonstratë me 8 nëntor në Podujevë. Ali Shukriu ka majttë ni miting t'madh atje. Ai ka qenë njo prej figurave ma t'urryera t'popullit. Ai mas Luftës së Dytë Botërore ka qenë edhe prokuror dhe me dorën e ti, domethonë, ka çu plot njerëz n'atë botë dhe ka qenë prej tona figurave ma i urryeri dhe ka mbetë faktikisht.

Ne do të donim atë tubim, atë miting i thojshim bile, se kishin thirrë popullatën me t'madhe me shku me marrë pjesë. I thojshin atëherë dita e shlirimit të Podujevës, '45-shi kur ka qenë ajo. Fati ka dashtë

që na kanë hetue. Bile sidomos Osman Dumoshin e kanë njoftë do që kishin ardhë këta t'sigurimit prej Prishtine. Ka thanë, "Janë t'u na ndjekë". Bile Osmani u ardhë ka bujt këtu të premtën, se ditë e shtunë ka qenë ajo. Po ta kishim organizu atë demonstratë ne do t'shploheshim dhe nuk do t'mbaheshin ato që u mbajtën me 27 nëntor. Ishte fat që nuk u mbajtën.

Bile do t'ri që ken' që i patëm angazhue për atë, të Podujevës ishin ata pjesa dërmuese. U prekën, tham, "Jo, jo s'oj kjo kurgjo hiç", po tani doli që fort mirë që s'ndodhi ajo. U mor' vendim që të... n'bazë tash të asaj strukture prej nantë veta që e bam i angazhum edhe lidhjen me Gjilan dhe me Ferizaj dhe me Podujevë. Domethonë në këto vende edhe ato ma herët. E në Prishtinë në orën 15 minuta para 04:00 e kemi pasë.

Janë mbajtë në Podujevë, janë mbajtë në Gjilan, janë mbajtë në Ferizaj. Tani ata masanej kush ka mrri ia ka msy prap Prishtinës edhe me ata organizatorët që kanë qenë në Podujevë, Gjilan edhe Ferizaj. Që me ba ma shumë. Se duhet me ditë numri atëherë nuk ka qenë, t'themi, sa u bo dikur edhe 40 mijë studentëve në Prishtinë, u bo universiteti me ma shumë studentë në Jugosllavi ka qenë ni kohë.

Unë dhe Skenderi i kemi shkruë ato parollat dhe kemi ngarkue në ni çerre me kuaj dhe i kemi pru para Fakultetit Filozofik, n'këtë rrugën e epërme tash ku osht' ai Instituti i Kimisë, a e dini ku ka qenë? Tash osht' galeri m'duket. Aty kemi ardhë. Po mos harroni, ajo rrugë s'ka ekzistue. Kjo rrugë osht' tek mas '70-tave. Aty kah konviktet s'ka pasë konvikte, ara ka pasë. Domethonë s'ka pasë rrugë. Tash kur ju thom aty kemi ardhë, deri aty ka qenë rruga, aty s'ka pasë ma rrugë.

Na kanë pritë studentët dhe shpejt e shpejt i kanë marrë dhe jemi nisë knej kah qendra e qytetit. Kur kemi ardhë, atëherë ju kanë thanë te Tre Sheshirat, do të thotë, ajo para se me shku te Grandi. Ka ardhë kordon i madh i policisë dhe na ka pre rrugën. Kanë ardhë prej Krlevës, ni qytet i Serbisë atje. E kemi shpartallu atë kordonin e policisë. Kemi ardhë deri te teatri. Te teatri ka fillu t'flas nji... optika ka qenë atëherë e Simon Shirokës atëherë ngjit me teatrin...

Anita Susuri: Ende është aty.

Ilaz Pireva: Edhe në atë far' platoje ka fillu Osmani nuk ka mujt e ka marrë tani fjalën Skender Kastrati. Atëherë kanë fillu me më sulmue policia, me zjarrfikës, me karrpaça. Bile ni shok tonit aq keq i kanë ra saqë veç shkonte sa andej sa këndej se i kishin pas ra në kokë. Tani e kanë marrë e kanë çu dikund me asi, se ai ma s'ka ditë ku osht'. E tash ka fillu m'u bo, t'thomi ma e ashpër, demonstrata. Kanë fillu t'thehen edhe vitrinat e dyqaneve. Domethonë ua kanë marrë zjarrfikësve atë t'ujit, se kanë dashtë me na shpërnda me ujë. Kanë mrri me ia marrë ato edhe kemi vazhdue deri te Fakulteti Filozoik tani andej.

Kanë dalë Mark Krasniqi edhe disa të tjerë, kanë dashtë ta qetësojnë pak situatën. Kërkesat, kemi pasë kërkesë, "Hajdeni po bisedojmë". Se ju kanë thanë atëherë këta politikanët... Fadil Hoxha s'ka qenë këtu, ka qenë në nji tubim atje... se ka qenë ai 28 nëntori i tyne. Ai s'ka qenë këtu. Po atëherë ni prej

figurave ka qenë kryetari i Komitetit të Prishtinës Rrahmon Bakalli. Siç duket ju ka thanë, “Hajde thirrni ata studentët po bisedojmë me ta çka po dojnë, tek po dojnë”. Ne s’këm dashtë me bisedue. E kemi ditë që ajo osht’ lojë, m’i qetësu ato.

Jemi kthye prap edhe tani aty shokët, shokët brohoritej se thoshin që disa i kanë arrestue. Osht’ msye me shku ku osht’ tash, kemi kalu “Grandin” te ajo rruga që shkon kah qendra rinore atje, tani burgju u kanë pak ma nalt. Tash e dini, besoj e dini ku osht’ burgju. Po aty s’kemi mrrri. Bile aty tani u vra Murat Mehmeti. Tani prapë jemi kthy qashtu nëpër qytet. Janë thy ato vitrina po kërkush s’ka prekë në to me thanë sikur zakonisht ndodhë tani i marrin ato sene e krejt ato, jo kërkush s’ka prekë kurgjo hiç.

Dikur vonë do të thotë ka përfundue, kanë fillu arrestimet që n’mëngjes Osman Dumoshin e kanë arrestue. Të tjerët tani. Unë jom i arrestuni i fundit, unë tek me 25 dhetor, domethonë, gati ni muj mas demonstratave jom arrestue...

Anita Susuri: Si ka ndodhë arrestimi ju?

Ilaz Pireva: Ka ndodhë kur kanë bisedue nuk kanë qit’ nuk dijmë ato... dikur bile unë kom shku, këtu osht’ mbajtë ni tubim edhe kom shkue... se fillun ato tubimet m’i mbajtë nëpër vende të ndryshme. Edhe në fakultete kom marrë pjesë ku dojshin m’i dënue demonstratat. Kom marrë pjesë edhe këtu në Lupç edhe jom çu i kom mbrojtë.

E ata tash që kishin ardhë tash t’komitetit edhe do gjykatës e andej këndeje edhe prishet puna edhe m’thrrasin. M’thojnë, “Biri pishmon se s’këm ku shkojmë në Podujevë me kto që je t’u i deklarue ti”, unë pritsha çdo moment arrestimin. Bile ndihesha keq qysh shoktë janë arrestu unë hala (qeshë) jashtë. Thashë, “Jo unë çka pata me thanë e thashë ku ishte vendi m’u thanë”. Ditë e hënë ka qenë ajo, t’mërkurën më kanë arrestu.

Po ato që ua thashë edhe n’fillim kanë qenë, po thom, në suaza krejt asaj korrekt, “Çka keni dashtë? Pse keni dashtë?” Po as fyrje, as sharje, as kërcënime, as kurgjo. Jemi mundue me atë kaqikun tonë me arsyetu ata. Pastaj, mas tre mujve osht’ mbajtë gjykimi, jemi dënu prej tri deri në pesë vjet. Ka pasë plot të tjerë që janë dënu dy muj, gjashtë muj, tre muj, ni muj si pjesëmarrës të demonstratave. Kemi...

Anita Susuri: Ju sa jeni dënu?

Ilaz Pireva: Unë tri vjet po tani kom mbajtë dy. Kemi shku në Nish. Aty bile kam gjetë tani, kam lexu ni gazetë e Beogradit ka qenë javore nifar’ Nin. Ajo ka qenë ni gazetë prej gazetarëve ma t’fortë po pro serbe, u mor’ vesh. Ata fillojnë tash t’flasin për demonstratat e Beogradit dhe thotë, në organizimin e demonstratave të Beogradit kanë qenë akademia, ka qenë universiteti, ka qenë edhe ni, keni dëgju nifar’ Francus Kaseda i thonë ajo osht’ shoqata e shkrimtarëve. Ka qenë shumë aktive për këta e për neve shumë e mrapsht.

Veç nuk e përmenshin kishën se atëherë kisha ka qenë pak ma e lanun pas dore. Se faktikisht strumbullari i krejt ktyne osht' kisha tani vijnë akademit e vijnë universitet. Ne thojshim, "O zot, kur do t'jemi bashkë profesori dhe studenti". Profesorët e kishin asi, studentët ishin ata që i realizojshin ato kërkesa që i kishin bo profesorët, akademikët, shkrimtarët po edhe kisha. Pastaj që thashë në '70-shin u hap universiteti. Fillun ardhje nga mbarë trojet shqiptare.

Ka qenë knaqësi e veçantë kur kanë pa që po flitet në krejt shqip, kanë pa filmat shqip, kanë pa jetën shqip. Edhe atë çfarë thashë, tash fëmija e tyne ose vëllezërit dhe motrat e tyne thojshin "Jo, jo na po dojmë në Prishtinë me shku me studiu, jo në Tiranë". U bonë lidhjet tani edhe familjaret edhe krejt ato. '74-ten nuk u arrit ajo që mendohej që Kosova t'jetë e barabartë me republika, po ishte vetëm element. Mendonim të jetë njësi federative, jo element federativ po njësi, këtu ishte ai dallimi. Nuk u arrit domethanë. Mbeti prap në ni mënyrë edhe me Serbinë edhe me Jugosllavinë. Nuk mundi m'u shkëputë prej Serbisë.

'74-ten kanë ra do grupe për shkrurjen e parullave nëpër konvikte. U ra ni grup, do i kom njoftë. '75-shin po ashtu vazhdoj ai shkrimi i parollave nëpër disa vendbanime po ma shumë n'atë pjesën e Gjilanit e të Kamenicës. Titoja erdh në ni vizitë '75-ten. Ishte në Maqedoni prej Maqedonisë në pranverën e '75-tes erdhi në Brezovicë. Mbas asaj në maj fillun arrestimet këtu. Na që n'fillim kena thanë, "Tanë jetën kështu kanë me na ndjekë. Duhet të msohemi me këtë". Nejsë, ranë ma së pari Skender Kastrati që unë e njifsha, ra në burg. Ma vonë disa të tjerë.

Po m'thojnë baba e këta, "More djali jem, do shokë tu po thojnë i kanë marrë n'burg, a keni naj sen?" I thom, "Jo babë, kurgjo s'ka". Ma vonë ni shef i stacionit të trenit këtu shqiptarë ka qenë i qatij fshatit që thashë, Vranidoll, vjen natën te baba. Ujup e ka pasë emrin baba. Thotë, "Baci Ujup, do t'sigurimit po rrijnë te unë aty", se ish shef i stacionit aty n'zyre, "dhe po e përcjellin Ilazin". Baba po thotë, vjen prap, natën kishte ardhë ai, unë nuk e kom pa. "Djali jem", qishtu qishtu po thojnë. Thashë, "Jo babë s'kom kurgjo". Me të vërtetë s'kisha kurgjo.

Prap masanej ka ardhë, "Baci Ujup, djali s'i ka puntë mirë", prap baba m'thotë, "O' babë, s'kom kurgjo". Ishte e vërtetë që na me shokë jena en, kanë ardhë. Bile niherë që ju thashë me atë profesorin e gjuhës shqipe që kena pasë në Shkollë Teknike Sadri Fetiu edhe ai i përndjekun. Ka qenë gazetar bile në radio tani ka ardhë aty te na. Tri ditë kemi qenë këtu, odën e kemi pasë atje domethonë. Kena bisedu po diçka ma tepër jo. Me 15 shtator në ora 05:00 t'mëngjesit rrethohem, jo kjo shpi se kjo shpi osht' e re tash (qeshë), ajo u prishë aty. Hyjnë plotë polic e plotë edhe ni police.

Unë e kom pasë ni hallë në Turqi, janë kthy ata bile kojshi i kemi qaty. Do rrobaqepësa që kanë qenë përpara aty. I kisha hallat krejt këtu edhe vijnë hyjnë n'dhomë aty. M'arrestojnë. Përllahem me ta. Qashtu prej shtratit në stacion t'policisë atje. Atje jom veshë bile. Masanej bile m'thojshin, "Kanë qenë 40 polic kur m'kanë rrethu". S'i kom besu ta them t'drejtën thojsha pak numër i madh.

Po ma ka thanë tani njo i sigurimit kur m'kanë marrë në '89-shin për Leskoc atje, "A po m'njeh?" Thashë, "Jo more ku me t'njoftë". Ishte një serb i Shtimës. Tha, "Unë kom qenë te shpija jote", tha, "Kur", thashë, "ke qenë te shpija?" "'75-ten", tha, "kur t'kena marrë. 40 polic", tha, "ta kena rrethu shpinë, ti s'e ke ditë krejt mali", tha, "u kanë i rrethun me polic". O zot, thashë, po çka kanë pasë nevojë. Që veç ni ftesë me ma pasë çue unë isha shkue. Nejse.

Që jom shku, përnihërë kanë fillu torturat. "Ti punëtortë e mi na ke sulmue, ata prej orës 02:00 derisa ta kanë gjetë shtëpinë". Ka fillu ajo telashja. Tortura t'cilat kena mendu që '66-ten janë ndalë. Se edhe '64-shi ka pasë tortura t'rana. Siç dihet ma Fazli Grajçevci ka ra n'tortura në atë me pasoja ka mbetë. Po tash t'u ditë '68-tshin mendojshim që ato janë ndalë. Tani ma '75-shi i kishe krejt njerëzit e tu. Se kaniherë po përdorim atë shprehjen shqipfolës. Jo more shqipfolës po shqiptarë janë. Tash tjera s'po asi veç jo që dijnë me folë shqip po të shqiptarëve janë. Nanë e babë e krejt. Jo veç shqipfolës.

Tortura, tortura deri në çmenduri. Fymje ma t'randa, familjen me nanë, me babë, me gru, me fëmi me krejt. Krejt serbët veç rrishin dëgjojshin, tanët i bojshin ato. Po thojnë që historianët nuk e kanë guximin hala me marrë këtë proces me shkoqit çka ka ndodhë, tek ka ndodhë. Nashta do sene edhe osht' mirë mos m'i ditë, si duket qashtu koka jeta. Masandej atëherë gjashtë muj ditë kom nejt në Prishtinë qaty as njeri t'gjallë s'kom pa. As s'kena pasë shëtitje që osht' elementi i parë i t'burgosurit e ka të drejtën me dalë nja dhetë minuta me... jo hiç, asni gja.

Mas gjashtë-shtatë mujve m'kanë çu në Mitrovicë, këtu tonën. Mas ni viti m'kanë çu në Mitrovicë të Sremit. Kam kry atje '79-ten. Që kom ardhë mas ni kohe prapë janë ardhë policia këtu. Tha, "Vjen Tita në Prishtinë, ti ni javë ditë je ardhë tash prej burgut s'po të çojna në burg po me nejt në shtëpi". Burgu shtëpiak që po i thojnë tash. "Ani bre, rri edhe ni javë ditë në shtëpi". Ka ardhë Tejatoniqi në izolim m'kanë marrë, në Lipjan. Mas asaj në '89-shin na kanë çue në Leskoc nja 200 vetë, 200 e sa. Na kanë dërrmue.

Unë kom qenë bile i ulun me akademik Rexhep Ismajlin në autobus aty kah na kanë çu. Masanej na kanë shpërnda. Mu m'kanë çu në Zajeçar ni qytet, dikond e kanë çu për Beograd. Mas dy mujve disave na kanë lëshue. Atëherë i thojshin izolim. Megjithëse nga terminologjia këta e kanë heq atë fjalën izolim veç ndrrim i vendbanimit i kanë thanë. Se dijnë ata me lu me ato far' termash. Janë ardhë prej Beogradit, se ka alarmu ni i sigurimit, ni shqiptarë kur, se t'u u çelë dera e autobusit kordoni i policisë deri na kanë shti atje t'u na rreh. Na kanë rreh edhe niherë krejt e tani na kanë desh krejt qysh na ka falë zoti. Prap, prap, e prap.

T'nesërmen na kanë lëshu vendimet, a din, bajagi po ua lëshojmë... prapë edhe aty na kanë shti n'kordon t'policisë edhe aty krejt ato... edhe erdhi '90-tshi prap demonstrata. Ylfete Humolli vrahët me 02 shkurt ktu në Lupç. Fillon masanej Pajtimi i Gjaqeve...

Anita Susuri: Para se me kalu te të '90-tat po du pak m'u nalë te burgjet nëse kishim dashtë me folë për këtë pjesë. Po m'intereson '75-ten, jeni gjyku bashkë me grupin e Adem Demaçit, a po?

Ilaz Pireva: Po.

Anita Susuri: Qysh ka shku ky gjykimi? Sa janë dhanë, po mendoj, sa vite janë dhanë? Po m'duket ka qenë maksimumi Adem Demaçi?

Ilaz Pireva: Po, maksimumi Adem Demaçi, i dyti Skender Kastrati të cilët i kanë mbajtur deri n'fund te dytë. Ai osht' ni proces, po them që '64-shi ka qenë po... se unë i kom përcjellë proceset e '64-shit edhe grupit të Mitrovicës edhe grupit të Gjilanit. Ndërsa në grupin e Adem Demaçit, këta të Prishtinës nuk kena mujtë me hy aty. Pos e mbaj mend shumë qartë ata sikur tash e kom atë pamje. Na kena nejt përballë hymjes të gjykatës, tash ku osht' çka janë këto të tjerat, ju e dini ku osht' gjykata aty.

Baca Adem si Baca Adem ka ardhë me durë të lidhuna edhe ka hypë atyne shkallëve. Bile i ka pasë do pantoll pak ma t'shkurtë (qeshë) sesa zakonisht. Se me pasë qenë këta t'sotit kisha thanë mos osht' i (qeshë)... edhe u kthye prej neve prej qytetarëve që ishim mbledhë këtë anën tjetër të rrugës me durë lidhur edhe na ka përshëndet me dy durë naltë do të thotë. Po me hy nuk kena mujtë. Dy proceset e tjera i kom ndjekë, i kom ndjekë gjykimet.

Ky ka qenë krejt diçka... ma s'pari nuk osht', kur m'kanë çu dosja kishte qenë {shpjegon me duar trashësinë, më shumë se 50 centimetra} aty. U ardhë gjykatësi hetues, ka ardhë prokurori edhe ka ardhë edhe ni tjetër. Ka thanë, "Ti nuk je në dorën tonë", as gjykatësi hetues, as prokurori, "je në dorën e sigurimit të shtetit". Domethonë, se ma s'pari shkon ajo gjykatësi hetues tani vjen prokurori tani anej këndeje. Ata i bojnë do lojë po i bojnë pas perdeve. Po jo tash landë e drejtpërdrejtë të sigurimit të shtetit.

Kom qenë në ni dhomë ku s'ka pasë dritë fare pos kanë qenë, sikur qato vrima {tregon për disa vrima në dhomë} atje. Njejtë sikur ato, veç ato kanë qenë të llamarinës të trasha. Dritë s'ka pasë. Tash ato s'kanë lanë me dalë hiç. Ditën ke nejt kështu, natën...

Anita Susuri: Në Prishtinë a po?

Ilaz Pireva: Në Prishtinë. Natën t'kanë marrë deri në 03:00-04:00 t'mëngjesit. Torturat ma t'randa, fyrjet ma t'randa. Por një ka qenë n'fund, ai hetuesi, se ata janë ndrru, ata ndrrohen. Vijnë, të torturojnë, të shajnë. Po dy i ki zakonisht kështu që janë ma t'përhershëm me thanë, a din. Ka fundi po m'thotë, "O' fol more e mos shko me këta t'parët po shko me këta t'dytit". Gjoja që këta t'parët shkojnë me dënime ma t'mëdha, këta t'dytit shkojnë me ma pak dënime. Thashë, "Unë s'kom çka flas se s'kom çka se ma s'pari s'kisha duru gjithë kto fyrje, le torturat po s'kisha duru edhe kisha folë, po s'kom çka. Ktu osht' halli".

Tha, n'fund m'ka thanë, "A e pin ni kafe me mu?" Thashë, "Ku kafe me ty bre?" M'ka thanë diçka në fund. Tha, "Nuk je as i pari, po s'do t'jesh as i fundit që do t'shkoni kështu", domethonë t'pafajshëm. Veç, "Do t'shkoni kështu". Kom thonë, pse po ma thotë këtë? Ka qenë si gorillë, dorën e randë kur thonë po fy s'më ka. A tjetër si qejt me ato fyrjet. Ka përmend edhe diçka, në përfundim që i kishin pasë çue.

Nejse, kur m'kanë çu tani në Mitrovicë të Sremit po lexoj Rilindjen, thotë, filan fisteku i priti Ansamblin e Kastriotëve. Kanë qenë Kastriotët e Ferizajit ni grup i këngëtarëve t'mirë n'atë kohë domethonë vitet e '70-ta. Filan fisteku në Konsulatën e Jugosllavisë në Gjermani. Domethonë prej këtu tash e kanë çu atje. Thashë, po naltë paske shkue. '81-shin kur kom qenë në izolim në Lipjan lexoj gazetën Politika. Filan fisteku u dënu me shtatë vjet burg nga Gjykata e Qarkut të Beogradit se ju ka dhanë të dhana të besueshme shërbimeve sekrete të përfundimit. Ishte ky.

Masanej kom takue nja dy djem dhe me ni kafiteri në Prishtinë dhe ai që e njëfsha unë t'zotin e kafiterisë ai ka qenë pak ma llafazan. Po i pytë, "Kush jeni? Tek jeni?". Thojnë, "Jem qishtu, prej Ferizajit". Se ky i Ferizajit atje. Nejse e thanë edhe mbiemrin. Thashë, "A e njihni filanin?" U kqyrën n'mes veti. "Valla", tha, "e njohim po", s'dojshin me folë. Thashë, "Jo, jo ma ka ofru atëherë ni kafe thuj t'ka çu fjalë Ilaz Pireva hajde pijmë kafe bashkë" (qeshë).

Anita Susuri: A jeni taku?

Ilaz Pireva: Jo, s'e kom pa. Veç qajo që m'pat' thanë për kafe, tash ai i murr shtatë vjet burg prej Gjykatës të Beogradit, qato që thashë nifar' enigme ishte te ai. Dhe i thashë, "Thuj, Ilaz Pireva t'ka çu fjalë, hajde e pijmë ni kafe" (qeshë). Ishte ky proces që, bile ata familjarët tanë, a din, mos kofsh keq se kqyrin me gjetë zgjidhje. Kanë pa marrë edhe do avokat t'njohur të Beogradit me na mbrojtë. As materialet s'ja u kanë dhanë avokatit me t'mbrojtë ty edhe mos me pasë aktakuzën tane. Ia kanë dhanë qatynë gjatë seancave edhe meniherë kanë thanë, "Kqyrni këto", edhe ua kanë marrë.

Ishte do të thotë në çdo aspekt, prej asaj që nuk u mbajt në ndërtesën ku duhej t'mbahej gjykimi. Ndërtesën në institucionin që osht' gjykatë po jo me ta improvizue ni sallë. Afër burgut atje e kanë improvizue ni sallë dhe prej burgut na kanë sjellë drejt në atë far' salle. Osht' mbajtë natë e ditë ajo deri në 12:00 të natës ato proceset, veç m'i kapërcye. Kështu që në çdo aspekt domethonë prej torturave...

Prej atyne procedurave të tjera kanë marrë gjykatës në Prizren, kanë marrë prokurorën e kanë marrë në Pejë ndërsa gjykatësin hetues dikund i Rahovecit, sipas mbiemrit qashtu diçka. Domethonë prej regjioneve tjera kanë pru në Prishtinë se s'ka pasë Prishtina gjykatës edhe prokuror po u dashtë me shku m'i marrë atje.

Anita Susuri: E hetimet sa kanë zgjatë për juve?

Ilaz Pireva: Po hetimet kanë zgjatë, ato që thashë, tortura ni muj ditë kështu pa, pa... mu se me 15 shtator jom arrestue, Ademi me 06 tetor osht' burgosë. Domethonë Ademi osht' i fundit që osht' burgosë. Prej majit që ia kanë fillue. Tash del do far' djem të ri student kanë shkru diçka parolla po na të '68-tes edhe Baca Adem hiç kurgjo. Po pse qysh tek ato janë çashtje tjera që duhet dikush tjetër t'i thotë këtu. Po them... vijmë te '90-tshi.

'90-tshi ajo prap ni frymë e afrimit, e pajtimeve. Pajtim n'emër të çështjes, n'emër që i falej Kosovës jo hasmit që kishte vrasje të randa. Nuk ishte pleqni, se ktyneherë janë ba pleqnitë. Domethonë kanë nda drejtësi sikur gjygi që ndan drejtësi e ato pleqnitë janë munu anej kënde. Po kësaj radhe ka pasë veç shtrimje të dorës. M'u ofru m'u pajtu për ni çashtje shumë t'madhe. Ajo ka pasë efekt t'madh, t'cilës ndoshta edhe sot për ni diçka të tillë kemi sot nevojë, m'u ofru. Sepse, "Bac u krye", nuk u krye. Na prap jena me ni zjarr, prap ni duhet ni përafrim se ta thom t'drejtën pak... dola diçka që tash nuk mundemi t'ua lajmë krejtve të tjerëve fajin po duhet të marrim edhe tonat.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Zoti Ilaz ishit t'u tregu ma herët për daljen prej burgut edhe si e vazhdu jetën në '79-ten, '80-ten domethonë. Jeni punësu?

Ilaz Pireva: '81-ten jom punësu në Fakultet të Mjekësisë. Kam udhëtue për çdo ditë prej Prishtine deri këtu, domethonë, në Lupç. Kam pasë, kam pasë ni çasje të veçantë me studentët e Fakultetit të Mjekësisë, t'u u nisë prej Shqiptarit [Demaçi]. Kom nejtë pak ma larg me disa aktivist që kanë qenë. Kom pasë ni bashkëpunim me ta. Kanë ditë pak kush jom edhe i kom orientu nga pak ata kryetarët e studentëve të cilët kanë pasë ni konsideratë. Deri në vitet e '90-ta kur na kanë largue. Pastaj, prap kur osht' hapë fakulteti kom punu tani me administratë të studentëve edhe aty atëherë kom qenë edhe kryetar i LDK-së në Podujevë...

Anita Susuri: Pas luftës?

Ilaz Pireva: Jo, jo në vitin '93, vitin '93. Po vazhdimisht kom punu në Fakultetin e Mjekësisë në administratë. Aty osht' punue për me kriju ni ambient sa ma t'mirë për studentët, për studimet. Se në qoftëse fakulteti mund edhe në ato rrethana të kryhet, mjekësia nuk don improvizime. Se t'kryesh ti mjekësi pa, pa laboratore, pa institucione, pa krejt ato çka i duhet ni studenti të mjekësisë mund t'jetë vetëm ni mashtrim. Po falë vullnetit shumë të madh që e kanë pasë kanë ba që të tregojnë që kur kanë shkue pastaj në vende të tjera në specializim kanë tregu sukses. Osht' ni e vërtetë që s'duhet të harrohet.

Fakulteti i Mjekësisë gjithherë e ka pasë pak ma lehtë me fëmijtë e vet. Sepse janë kanë fëmi të përzgjedhun në krejt Kosovën dhe jo vetëm në krejt Kosovën. Se ishte ni ambicie, të bohesh doktor atëherë i vetmi doktor ka qenë që ka mujtë me jetu pak n'atë nivelin çfare duhet edhe t'rrisë fëmijë edhe t'jetoj pak. Po osht' ni përgjegjësi t'jesh mjek në anën tjetër, shumë e madhe. Mirëpo i ka marrë fëmijtë ma t'mirë i ka zgjedhë. Konkurencën e ke pasë deri 1000 vetë janë pranë 150. Ka ra gati i shtati, i teti me ra krejt nxanës të shkëlqyeshëm.

Kështu që edhe atë periudhë relativisht mirë e ka përballu Fakulteti i Mjekësisë falë edhe kuadrit mësimor, angazhimit të tyre po edhe studentëve. Kështu që me kthimin tani aty ku e ka vendin studentit në amfiteatër, në laborator, te shtrati i të sëmurit tek atëherë mund t'arrihet ajo çka synohet. Po fatkeqësisht të gjithë kemi pritë që do t'ngjallemi pak ma shpejt dhe ma marë. Prap ka pasë do halle, prap... mos harroni, kriter shumë i ashpër ka qenë për m'u regjistru në Fakultetin e Mjekësisë. U rujt edhe në qato kushte të shtëpive shkolla. Dikur pak ka ra ai nivel.

Kështu që tani kom qenë dy mandate deputet i Kuvendit të Kosovës. S'po e përmendi atë mandatin e '92-shes deri '98-ten që s'ka mund të konstitohet Kuvendi i Kosovës. 2007-shin kom shkue edhe jom zgjedhë kryetar i Komunës së Podujevës. Ka qenë mandati i parë që kryetari zgjedhet me votën e drejtpërdrejt të qytetarit. Deri atëherë kryetarët i kanë zgjedhë ato Asambletë Komunale. Kam ba përpjekje duke pasë parasysh gjendjen shumë të randë mbas luftës, një, u kom premtu qytetarëve që hile nuk do t'keni, mundësitë i dini që janë t'vogla edhe për ni kryetar. Për aq sa mundet do t'bahet.

Kom thanë, unë prej fëmive t'mi dhe t'rrethit tim mos më ngushtoni me do sene, le të mbrijë dora jem aty ku ka ma së shumti nevojë. Kom pasë mirëkuptimin t'familjes, t'rrethit dhe ta them t'drejtën besoj që nuk kom ra në naj grackë të lakmisë, as të anëtarëve t'familjes as të rrethit. Tash shpesh ma thonë qytetarët, "M'ke ndihmu këtu", megjithëse ti s'ke mundësi fort të ndihmosh. Kështu që konsideroj jom nda i knaqun, po thom, edhe sot ma thojnë që nuk i njoh, nuk e di kush janë.

Jom kthye pastaj kam shku, kam qenë këshilltar i presidentit nja disa muj. Në rastin kur ka dhanë dorëheqje presidenti Fatmir Sejdiu atëherë u bo edhe mosha për pension. Kom dalë në pension me 75 euro. Më vonë falë atij ligji që osht' miratu në kuvend që stazhi u burgut me t'u njeh edhe stazh kështu i punës kam mbri që ta kam tash pensionin nja 260-270 euro do të thotë. Me pare të burgut e kom bo këtë shtëpi edhe me ndihmën e familjes. E kom ni vajzë atje në Londër. Ajo ka qenë iniciatore t'ia nisi tani...

Anita Susuri: Deshta pak për familjen me ju pytë, për ata se si jeni njoftë me gruan? Si jeni martu edhe a i ka ra me ju pritë prej burgut?

Ilaz Pireva: Ta them të drejtën pak martesë, martesë jeme tash me 16 korrik i bon 62 vjet. Domethonë m'kanë martu nana edhe baba me ato renet qysh kanë qenë ktynehere. N'atë aspekt unë, po thom, si familja tradicionale që kemi qenë, bile kur kom qenë unë në Burg të Mitrovicës së Sremit, jom taku

edhe me të burgosur të tjerë serb dhe malazez dhe rus. Kemi bisedue. Kanë ditë që jom për herë t'dytë në burg, kanë ditë që jom i martun.

M'kanë pytë, "Si po mundësh ti me përballu jetën n'këtë mënyrë?" Atëherë i kisha tri vajzat në '75-shin. Njanën ma e pata lanë ni vjet e diçka. Thashë, "Nuk e kom hall, jetoj në bashkëshi familjare me babën", e kisha edhe axhën, "me vllazën, me djem t'axhës. Unë as s'mund t'mendoj a kanë bukë fëmija, sa kanë edhe ata i kanë edhe ata. I kanë të gjitha kushtet. Bile janë ma t'privilegjun se fëmijtë e tjerë", "E", tha, "për ty koka kollaj me mbajtë burg".

M'kanë pytë edhe një, se edhe ata ishin për herë të dytë, një çështje që është me rëndësi t'përmendet. "Po na intereson si t'kanë pritë rrethi", tha, "kur je kthy prej burgut t'parë?" Thashë, "Ni muj ditë ka qenë dera e odës çelë", thashë, "që kanë ardhë me më vizitue dhe me m'thanë mirë se ke ardhë dhe të tjera fjalë që i thuhën njo që kthehet prej burgu", "E", tha, "po ju po dishi pse po mani burg. Neve", se kishin majtë burg edhe përpara, "jo që na ka vizitu dikush po s'na kanë folë edhe më të afërmit. Na ka injorue". Prej tyre që të gjithë kanë qenë të ndarë prej grave, domethonë familje të shkatërrune.

Anita Susuri: A kanë qenë ata të burgosur politikë a?

Ilaz Pireva: Po, po politikë. Ishte fjala për politikë. Se ishin do që kishin ra në '48-tshin me hi në nifar' byro kishin ra në burg tani për herë të dytë në vite të '70-ta kishin ra dhe tash ata kur ju thojsha që kështu, kështu në familje. "Ju po dishi pse me majtë burg, e na jemi shkatërrue dhe rrethi s'na ka pranu kur jena kthy prej burgut". Po them, të gjithë kishin qenë të ndam prej grave.

Vetëm një, po them, ai kishte pasë gruan t'përkushtune. Bile kishte pasë ni profesion tjetër. Ka shku e ka kry për infermiere, se ky ka qenë i sëmurë, për m'i ndihmu burrit. Vetëm ky, ni Moraça ka qenë, ajo ka qenë familje e njohur në Luftën e Dytë Botërore edhe ka pasë plot gjeneral. E gruaja e tij, ky i Vojvodinës atje, ajo osht' rikualifiku për infermiere për m'i ndihmu burrit. Bile burri tani i ka vdekë në burg.

Kështu që te na të gjithëve, unë e përmenda rastin tim po kështu ka qenë me të gjithë, do të thotë. Unë e kisha grunë smutë, e kom pasë, u bo operacion e s'ka besu kush që po pështon. Tani vishin do shoqe t'sajna kështu me asi, unë i bojsha hyzmet. Sikur juve që ua dhashë kah ni gotë ujë. Ma bojshin, "Lumja ti sa sevapin", thojsha, "O' gruaja po m'thotë kurfar' sevapi s'ki veç ishalla i lan borxhet". Ajo s'më ka thanë kurrë po unë ia thojsha atyne po thotë, "Veç ishalla i lan borxhet". Realitet, shiku drejt, ashtu osht'. Domethonë n'qoftëse mundemi m'i la borxhet.

Anita Susuri: Po m'intereson edhe nëse keni naj kujtim prej burgut në Mitrovicë të Sremit, po me m'folë pak edhe për vizitat edhe sa ka qenë e vështirë për familjen e juv me ardhë deri atje me ju vizitu?

Ilaz Pireva: Në Burg të Nishit, kur kom qenë në Burg të Nishit ka lind qikjo vajza, Afërdita. Do të thotë fëmija nuk asi... në Mitrovicë m'kanë ardhë... këtu nuk m'i kanë lanë fëminë m'i pa fare. Domethonë ni vjet kom qenë në Mitrovicë nuk i kanë lanë fare fëminë me ardhë. Këtu ma gjashtë muj. Atje po. Unë e kom pasë ni fotografi timen aty në dhomë. Kur janë ardhë me m'pa të tri vajzat, ato janë ardhë me atë pamjen që e kanë pa fotografinë, me atë imazhin.

Kur janë ardhë e kanë pa ni njeri tjetër, me ato veshjet e të burgosurit. Kanë thanë, “Ky s’osht’ baba ynë”. Domethonë nuk ishte lehtë, e din, që fëmija t’thotë, “Ky s’osht’ baba jem”, se ai babën e ka pasë n’syret këtu në dhomë. Nuk osht’ përjetim i lehtë. Mirëpo një duhet t’kuptohet që me kohë kemi ditë që ma s’pari vehtën pastaj kur vehtën ti munësh edhe tjetrin, domethonë edhe gruan, edhe nanën edhe babën edhe fëmitë në ni mënyrë m’i sakrifikue. Sa osht’ e drejtë ajo çashtje tjetër po ti me vetëdije e bon atë.

Unë, sidomos, kom pasë përkrahjen e madhe të familjes. Për atë aspekt nuk kom... as çka ndodhi as pse mbetëm kështu se nuk ka qenë jeta fortë e lehtë. Ato tani pasojat... se vëllaun tani ma kanë largu ni vjet, ni vjet jo po dhjetë vjet ka qenë i papunë shkaku im do të thotë. E mos t’flasim për pasojat e tjera. Mirëpo një ua them nga shpirti, krejt këto çka kanë ndodhë me neve kryet e kanë pasë në Beograd edhe osht’ ma lehtë e përbalueshme. Çka m’i bo kur ta kryet n’vendin tonë. Ajo nuk, nuk përbihet. Se kur e ka te hasmi yt atje shekullor nuk kemi çka t’flasim.

Kështu që, bile atë ditë, e pashë intervistën e Shqiptarit tha, “Mu s’më kanë pengu gjatë shkollimit”, tha, “Serbija osht’ e meçme, ajo merret me punë t’mdhaja nuk merret me këto”. Do të thotë s’ia kanë ndërpre, s’i kanë thanë Demaçit, këti Shqiptarit m’i thanë, s’munësh ti, e hupë të drejtën e shkollimit, ani, ani shko ti po na tjetër kah punojmë ne për... prandaj, Serbia ka politikë t’mençur, t’fortë, t’ulët krejt. Prandaj, mundemi me thanë që familja osht’ rujtë. Familja osht’ rujtë.

Anita Susuri: Sa shpesh keni pasë vizita?

Ilaz Pireva: N’mujt. Niherë n’mujtë i kena pasë vizitat. 15 minuta. Përkthyesja e ke pasë te kryt domethonë, ka qenë që çështje familjare ke mund t’bisedosh diçka tjetër jo. Letrat qashtu, nga ni muaj m’i çu edhe atë mirë jom, qofshi mirë. Domethonë diçka tjetër nuk mundësh me... Mitrovicë të Sremit osht’ hera e parë... mu bile kur m’kanë çu, m’kanë çu me ni, me ni serb dhe ni malazez. Bile ai serbi ka qenë prishtinas, babën e kishte pasë drejtor të teatrit në Prishtinë edhe ai politikisht. Ata e kanë kërku partitë të re komuniste, jo ata që paska qenë. Ni djalë i kthjellt. Bile ju ka thanë ai komandanti i policisë aty t’burgut, i gardianëve, “Ka me ua pru ni bashkëvendas t’jujin që s’keni me mujtë me ta me ba”.

Po shoh unë, ata ni kujdes t’jashtëzakonshëm ndaj meje. Se thotë, osht’ pak {shpjegon me duar, me gjasë me probleme}. Shumë m’rrijnë gati për çdo sen. Mas ni muji... se ai malazezi ma, a ky ma, i pregatitun. “Ilaz”, tha, “duhet me të tregu”, qishtu qishtu, “na ka kërcënu ky komandanti i gardianëve që ka me ua pru ni bashkëvendas”, se kishin refuzu t’punojnë. Tha, “Ti krejt sjellje korrekte, normale

çdo gja”. Masanej kena hy n’biseda. Ia kom shpjegu edhe çashtjen e ‘68-tes se ata e kishin interpretu krejt ndryshe. Qysh e interpretojnë te na. Kemi hy... kanë ardhë tani edhe të tjerë kanë ardhë n’dhoma të tjera kanë qenë edhe ata t’burgosun.

Kena bo ni polemikë, për herë t’parë boj unë me serb ni bisedë dhe polemika të ashpra. Aq pa arsyeshëm kanë qenë saqë ‘81-shin ke mendue ata paskan ardhë prej burgut dhe ata paskan marrë pushtetin. Se tani unë fillojsha t’i lexoj ato gazetata e Beogradit çka po shkrujnë, a din, për krejt ato me politika, me intervista, me “Danas-a”, me drej e t’mallkun. Mendoj se ato biseda që kisha bo unë me ta, tash i kishe nëpër gazeta dhe i kishe nëpër televizione. Domethonë e njejta logjikë. Bile kur thojnë kanihere, “Çetnikët, çetnikët”, s’ka çetnik e partizan, një janë. Diçka ma të veçantë aty në atë burg kemi qenë të izoluem...

Anita Susuri: A keni pasë shëtitje?

Ilaz Pireva: Shëtitje po, shëtitjen e kena pasë. Ka qenë burg që e kanë vujtë edhe këta të huajt aty, ndërkombëtarët domethonë aty. Trajtimin duhesh m’u përgatitë domethonë, mos me t’lanë me t’fut në do gracka. Se t’i bojnë do përgatitje që... kështu që duhet... na kena bisedu edhe ma herët, duhet prej burgjeve me dalë ma me pak pasoja. Se në burg s’munësh me bo kurgjo tek e fundit. Kështu që u kapërcy edhe ajo. Po të vetëdijshëm që... bile kur i kom pasë thanë atëherë ‘75-shin ni hetuesit të sigurimit, thashë, “Unë kom mendu që e kom kry burgun atëherë”, për ‘68-ten, “dhe jom ba si tanë qytetarët tjerë”, “Jo bre, ti s’bohesh kurrë si qytetarët e tjerë”, tha, “50 vjet masi që t’vdesësh atëherë i mshohet vi emrit tond dhe të tjerëve”. Të vërtetën realiteti ishte i tillë.

Siç e thashë atëherë ka qenë në ‘74-ten ni përmbysje në Kil, Alendën e patën përmbyll. Ni Pinoçeti⁴ bile e kanë pasë zanë tani n’fund të 2000-shit a ‘90-tshit, e patën marrë ata gjeneralët. Ai ni sistem socialist i atij Alendës. E patën mush ato stadiumet me njerëz të arrestun, se s’kishin vende. Patën bo terror e vrasje. Pata thanë, a din, “Ju jeni t’u veprue sikur në Kil atje”, thanë, “Mbaje mend njo”, ma tha tani, ai i sigurimit, “polici si këtu si në Kil atje si në Kinë si në Amerikë si në qat’ Shqipni që p’e doni polici osht’ polic”, edhe del që polici osht’ polic (qeshë).

Anita Susuri: Po m’intereson tash edhe ‘89-ta që e përmendet që ju kanë marrë edhe që keni qenë në ato tortura. Sa ka qenë... thatë diku 200 njerëz kanë qenë.

Ilaz Pireva: Më shumë se 200 po mbi 200, se osht’ edhe libri për ata po osht’ “Izolantët” osht’ ni libër. Po ata që na kanë çu në Serbi do të thotë, në Vrajë na kishin pa çue, në Leskovc, në Valevë, në Prokuple tani Zajeçar, Beograd. I kanë mushë... po osht’ interesant me theksue që ‘89-shi pjesa dërmuese e të burgosurve ka qenë, jo ish të burgosur politikë po kanë qenë kuadra udhëheqëse nëpër ndërmarrje. Se

⁴ Augusto Jose Ramon Pinocet Uagrite (lindi me 25 nëntor 1915 në Valparasio të Kilit dhe vdiq me 10 dhjetor të vitit 2006 në Santiago) ishte gjeneral i ushtrisë kiliane dhe president më konkretisht diktator i Kilit i cili me anë të këshillit ushtarak dhe grusht shtetit sherbeu si gjeneral suprem dhe president i Kilit gjatë viteve 1973-1990.

edhe atëherë siç ju thashë në '68-tshin u bo ni debat për avancimin e statusit të krahinës edhe '89-ten u pat' bo ni debat për do ndërrime kushtetuese.

Ato debate u patën zhvillu edhe nëpër kolektive punuese. Tani aty kush osht' ekspozu pak ma shumë prej drejtorëve, shefave... tana ndërmarrjet kryesore të Kosovës kanë qenë, domethanë, njerëz udhëheqës të krejt atyne ndërmarrjeve shoqërore që kanë qenë atëherë edhe disa figura të tjera siç thashë. Unë kam qenë ulun me, ata e kom pasë profesor, Rexhep Ismajlin, edhe ni t'ish burgosun politikë. Tash kond e ka rrok fati nuk e di, a din, po mue, gjithëhere kom qenë aty...

Anita Susuri: A ka ndodhë edhe si arrestim a po?

Ilaz Pireva: Jo ata nuk tregojnë ata veç të kërcënojnë që ti je prej atyne andej këndeje. Po ta lëshojnë ni vendim veç ndrimi i vendqëndrimit, do të thotë kurgjo ma tepër. Po tani disave ua kanë vazhdu edhe masanej tani n'bazë t'hetimeve që janë zhvillu dikond edhe e kanë dënue domethonë. Po pjesën dërrmuese mas pesë-gjashtë muje i kanë liru. Neve na kanë liru mas dy muj ditëve. Kur na kanë malltretu aq rond, dikush, ni za ka mrri deri në Beograd dhe janë ardhë prej Beogradit dhe na kanë pa në çfarë gjendje jem.

Tani na kanë marrë, janë mundu me do barna, me do yndyrna me na ly trupit krejt me varrë. Tani na kanë shpërnda n'vende tjera, a din. Bile tani e ka pasë hapë gjoja ni proces kundra atij drejtorit të Burgut të Leskovcit. Bile na kena pasë çu ftesa me shku n'atë proces. Kom thanë, "Jo more nuk shkoj". E tash a din çka ka qenë ajo përgjigja e tij kur e kanë pyet, "Pse i ke malltretu këtë shkallë?" Ka thanë, "Në këtë gjendje na kanë pru prej Prishtinës". Do të thotë ajo ka qenë, ajo arsytimi i tij. "Jo na s'i kena prekë me dorë, runa zot, po kështu na kanë pru prej Prishtinës".

Anita Susuri: A osht' dënu diçka ai [drejtori]?

Ilaz Pireva: A?

Anita Susuri: A osht' dënu ai diçka?

Ilaz Pireva: Tre muj me kusht, a nuk e di. Veç, a din, formalitete se kanë ardhë prej, domethanë, se atëherë ka qenë Vrhovci ni kroat ka qenë i punëve t'jashtme. Ni Drnovček ka qenë kryetar i Jugosllavisë atëherë që janë kanë me atë rrotacionin.

Anita Susuri: E a kanë ndërhy ndoshta këto organizatat që kanë qenë Amnesty International e këto?

Ilaz Pireva: Ato kryesorja tash prej asaj qendres se vet fakti që kanë ardhë prej Beogradit e kanë pa gjendjen, tash po supozojmë nashta ka qenë iniciativë e kujt nuk mund ta dijmë. Po ma tepër, do të thotë, t'u marrë parasysht që ka marrë pak ka dalë jashtë ajo çka ka ndodhë në Leskoc aty. Tani, po prej

kujt... po çka ka qenë, po thom, në këtë rast e mira, njeri ynë ka thanë, “I kena lanë n’gjendjen ma t’randë ata që i kena çu në Leskoc”. Tani ka shtu naj fjalë naj kund. Tash qysh ka rrjedhë ajo nuk mund t’flas.

Anita Susuri: A mundeni tash me na përshkru rrugën edhe çka keni mendu ju që ka me ndodhë me juve? Ose se keni ditë ku po shkoni?

Ilaz Pireva: S’ke çka mendon në ato raste kurgjo hiç. Hiç ta thom t’drejtën. Se tani për mue prap këto krejt m’duken sene të vogla ajo çka t’ka ndodhë në ‘99-shin në Dubravë. Kështu që sikur edhe shumë të tjera... bile niherë m’vetën, “S’na ke bo naj fotografi naj inxhizim të shtëpisë t’djegun”. Leni bre ato sene. Ku përmendet shtëpia ose ku përmenden shumë sene të tjera.

Kështu që prap kur e mendon atë çka ka ndodhë edhe me plot të tjerë thu jo, mos, edhe kjo m’vjen me thanë mos kanihere pak mos p’e teprojmë, a din. Se një t’tua them t’drejtën, ke plot luftëtarë, ke plot veprimtarë kanë kry punë ti kurrë zanin s’ua ke nie. Do po i bojnë pak ma me zhurmë, pak ma anej e këndeje. Prandaj, kujdes duhet me pasë këtu. Kujdes duhet me pasë këtu.

Anita Susuri: Ju pastaj thatë pas dy muajsh jeni kthy n’shpi...

Ilaz Pireva: Po.

Anita Susuri: Edhe kanë pasu vitet e ‘90-ta. E përmendet Pajtimin e Gjaqeve, a keni marrë pjesë edhe ju?

Ilaz Pireva: Po kom marrë pjesë n’këtë pjesën këndeje. Kom marrë po nuk kom qenë pjesë zyrtare e atij ma tepër si veprimtar, si emër që kom pasë n’atë kohë, a din, n’atë aspekt. Po kështu i kam ndjekë, kam qenë edhe në Bubavec kur osht’ mbajtë ni tubim i madh edhe te Verat e Llukës, ai gjysë milioni i njerëzve që përmendet. Edhe n’këtë pjesën edhe jo vetëm atëherë po edhe masandej n’shumë familje kam kontribue n’afrimin e tyne.

Kështu që po them jam përpjekë me mundësitë se ka gjithëhere vend dhe ka hapësirë për t’punu mbarë edhe mirë. Bile kur kom qenë deputet aty në Kuvendin e Kosovës ma bojshin do që deri dje ishim bashkë po ishin tash t’radhitun n’atë anën tjetër. Ma bojshin, “Knej bre e ki vendin, hajde qiknej se atje”, “O’ a janë këta t’kqi, po i boj t’mirë edhe këta”. Kështu që nuk, nuk kam qenë i ngarkun me këtë a osht’...

Bile e kom qujtë ka qenë Partia Parlamentare bile Zahiri ka qenë në Partinë Parlamentare atëherë në Orllan edhe po vjen dikush po m’thotë, ni veprimtar që unë nuk e njifsha veç thoshte që osht’ i LDK-së, “Na kanë hi n’hise do t’partisë tjetër po i marrin, po i mbledhin atë 3%-shin”. Neve ni veprimtar na u ka mbyttë në tre tortura për 3%-shin. Unë ku me gjetë njerëz që hyjnë atej, a osht’ i paramentarës a është i

LDK-së... se tjera ka qenë ni fshatar a social demokrati a krejt ato... për mu ishte shumë e kapshme që tanë me veprue n'ato rrethana çfare jemi.

Kështu që thashë, “E çka po don ti me thanë? Leni more ato, ku me gjetë njerëz se ta thom t'drejtën nuk ishte kollaj m'i angazhu njerëzit. Siç për mue nuk ka qenë n'fillim na kanë vlej do letra që i kena pasë për ata që torturoheshin me ua dhanë që i hyshin në punë në perëndim. Në fillim kom hezitu, kom thanë mos po bohem unë sebeb po i ndaj prej familjes. Po dikur jom bind, ai që osht' i mirë, kudo që t'jetë ka me mbri dora e tij. Po t'keqin s'e ke as atje as ktu as kërkund.

Kështu që edhe n'atë aspekt duhet t'pasë parasysh solidariteti që ka ekzistue jo vetëm te pajtimi po edhe te kujdesi për me pasë ni kafshatë buke. Ka qenë edhe ni, “Familja ndihmon familjen”, edhe ajo ka dhanë ni kontribut t'madh. Kanë mbajtë familje plot familje për çdo muj iu kanë çue sa kanë pasë mrena atij standardi çfare ka qenë nevojë po them. Kështu që ishte ni fushë ku mujshe me vepru, me punue.

Bile ni torturë mu m'kanë marrë disa herë edhe këtu të ashtuquajtura biseda informative, policia e Serbisë. Janë ardhë qitu dy-tre herë ma kanë bastisë shtëpinë. Kena pasë fillu ni shkollë këtu në Majac me ndërtue unë e kom pasë projektin e saj dhe krejt ato, filloj me të madhe t'punohet erdhën na ndërpre. Janë ardhë ma kanë marrë projektin m'kanë thirrë m'kanë kërcënu. “E din që ky osht' sekret ushtarak projekti i shkollës”. Ata e paskan pasë qashtu. Se n'kohë luftime shkollën e bojnë objekt për nevoja të veta. Tashti na e ke marrë sekretin gjoja. Siç na kanë torturu niherë, na kanë shtri për toke kur osht' vra një i sigurimit të tyne. Shqiptar ka qenë ai, u vra.

Anita Susuri: Vitet e '90-ta?

Ilaz Pireva: '95-shi dikund atje. Mu si kryetar edhe shtatë anëtarë tjerë të kryesisë, po unë e kom ndi vetën ma lehtë sepse ditë e zotit që s'janë marrë veprimtarë m'u rrah nëpër stacione t'policisë nuk ka ndodhë. Kështu që unë e kom nda fatin edhe n'këtë periudhë edhe pse i kisha do vjet edhe pse i kisha pasë do halle asi. Po tash edhe me këta t'ritë unë prap ndajsha ni fat me ta. Kështu që mirë.

[Këtu ndërpritet intervista për shkaqe teknike]

Anita Susuri: A jeni gati?

Ilaz Pireva: Po po unë gati.

Anita Susuri: Po m'doket deshtët diçka...

Ilaz Pireva: Domethonë kjo sekretari i degës ishte komandant i mbrojtjes territoriale për zonën operative të Llapit. Erdhi tha, i çova fjalë faktikisht se e njëfsha, jo që e kom njoftë këtë po ia kom njoftë

edhe ni t'afërm të tij. I çova fjalë, ai e kishte dhandërr këtë. “Thuj Muhametit s’ki vend ma ngjitu nalt”. Vjen thotë, s’di a i kishte shku porosia. Po vjen ky thotë kështu, kështu, “E kom ndërmend...”, “Ju priftë e mbara, veç ni porosi, afroni njerëzit. ju jeni luftëtar t’lirisë, nuk osht’ ky i këtij ai i atij ju jeni të gjithë një”, “Valla unë nuk p’e disha këtë”, “Kam dëgju disa fjalë”, thashë, “prandaj veç po t’porosis edhe ty”.

Masanej kur e kom taku ka thanë, “Kish pasë diçka po i kemi kapërcye”. Domethonë kemi ofrue edhe ato dallime që kanë mund të ndodhin. Kemi sigurue miell prej tregtarëve të Llapit, kanë marrë me shumicë me kamiona prej Serbisë dhe i kemi çu deri te Leposaviçi përmes Shalës së Bajgorës. Bile ka mbërri që edhe hua m’ka besue ai tregtari se s’i kanë pasë niherë t’hollat, domethonë jemi kujdes. Edhe për gjendje tjetër unë e kom pasë çikën t’fejune, kjo osht’ si krim, a din, veçsa... pajën e saj, çejzin e saj me batanije me krejt ato, jorgana krejt ato që i ka përgatitë për nusni i kemi çu. Deshta veç si simbolikë, domethonë.

Kem organizu... qytetarët bile kanë shprehë atë meniherë, kom thanë, “Veç mos m’u gutni, mos më shpenzoni që n’hapin e parë se kjo nuk e dijmë sa ka me zgjatë. Kështu që edhe n’atë aspekt osht’ punu dhe mbi t’gjitha për përafrimin, për kujdesin, për... tani unë kom punu edhe në Fakultet të Mjekësisë. Aty ka qenë edhe shtabi për... dekani ai osht’ n’botën tjetër tash, Hashim Aliu, ku ka qenë... kanë përpilu orarin e krejt mjekëve që kanë me dalë n’teren domethonë. Mjekët s’kanë kursye kurgjo. Bile do na kanë mbetë edhe derisa ka përfundu lufta s’kanë mund të kthehen në Prishtinë. Domethonë osht’ n’tona poret, n’tona segmentet e jetës domethonë osht’ mundue dhe osht’ punue. Kështu që për të tjerat nuk mund t’flas.

Anita Susuri: Ju keni qenë këtu gjatë luftës a po?

Ilaz Pireva: Po. Unë kom qenë në Prishtinë bile pat vdekë këtu ni veprimtar, unë e kom pasë edhe ma afër sesa veprimtar. Ndalem këtu te udhëkryqi osht’ policia serbe. E panë se e kisha letërnjoftimin e Lupçit meniherë “*Kako ti je UÇK, kako ti je...*[srb.: Si e ke UÇK-në, si e ke...]” a din, si e ke si asi... e pashë që ma s’më ka mbetë me... edhe kom qenë në Mahallë të Muhaxherëve te ni motër kam ndejtë edhe deri me 4 prill ‘99-tes. 4 prill kemi dalë në kufi atje te Hani i Elezit në Bllacë. Dy ditë kemi ndejtë po nuk e kena përjetu atë tmerrin që e kanë përjetu ni javë ditë pa u ndalë shirat.

Kom qenë dhetë ditë me ni kamp aty afër. Kanë ardhë m’kanë thanë me shku dikund, kom thanë, “Jo”. Unë kisha ndërmend të shkoj kah Shqipëria. Ka ardhë një ushtarak i lartë i NATO-s, ka bisedu për disa gjana, ia kom dhanë edhe ni adresë me kond t’bisedoj, ia kom thanë edhe do sene që për fat të keq m’kanë dalë qashtu. Se ai ka qenë epror i lartë ushtarak i NATO-s po francez. Rolin e Francës që e ka pasë, për këtë që osht’ sot Serbia.

Prej aty kom shku në Tetovë prej Tetove prapë me do lidhje kom shku në Dibër me qëllim me shku në Shqipëri. Po e kom pa që nuk kom pasë vend, do të thotë. Edhe meniherë mbas asaj jom kthye. Ia kom fillue punës prapë këtu...

Anita Susuri: Në çfarë gjendje e keni gjetë vendin kur jeni kthy? Thatë që ju ka djegë edhe shpija?

Ilaz Pireva: Po, po këtu prej shpisë time që ia ka nisë e kanë djegë edhe nja gjashë-shtatë shtëpi të tjera të lagjes. Qato që thashë kom jetu disa vjet me qira në Prishtinë. Kur jom ardhë tani për kryetar ka fundi jom kthye këtu. Qato që t’thashë, kom bo tani dikur shtëpinë edhe tash po jetoj në Lupç të Poshtëm jo të poshtër (qeshë).

Anita Susuri: Tash jeni n’penzion m’thatë...

Ilaz Pireva: Në penzion po, po bajagi gjatë. Bajagi gjatë. Po tash ajo, qajo solidariteti i familjes tonë tradicionale hala po funksionon. Unë tash me ju t’rejave pak edhe me vajza t’mija... na kemi zgjeru rrethin që edhe nëse t’kom diçka n’vijë t’largët tash po thojnë ofroje rrethin, ofroje, ofroje rrethin. Tash m’u kujtu kur e kena miratu ligjin përkufizimi i definicionit çka osht’ familja e ngushtë, familja e ngushtë a din çka na del? Partneri, partnerja, gruaja, burri, nana, baba, fmija. Vëllau jo, motra jo mos t’flasim për axhallarët e të tjerët për të tjerët.

Bile ju pata bo vrejte aty thashë, “Heqne bre qita partneri partnerja”, e kishin qit’ para gruas, para burrit. Thashë, “Po përkthimi”, siç ishin plot përkthime të mrapshta... kështu që na e kena pasë atë përkufizimin e familjes bajagi gjon. Unë kom jetu me gjashtë halla, jom rritë në prehën t’tyne. Jo të motrave po të hallave. Kena pasë edhe do plaka të tjera që s’kanë pasë, ju thojshin, t’afërmit e tyne ju kanë dalë në Turqi. Na i kena marrë. Se atëherë ka qenë rendi këtu te na dy herë n’vjet m’i marrë bijat. I kena marrë edhe ato. Ose për dasma, për kanagjegje diçka. I kena marrë edhe do tjera pos hallave se s’i kanë pasë... edhe ato vi e largët.

Tash m’thojnë prej kësaj çikës Afërditës, “Ajo kohë ka kalue”. Tash duhet domethonë m’u përqëndrue afër, afër, afër. Unë kom thonë, jo bre rritne, rritne, rritne. Nji si përmbyllje se kur po shkruhet jo vetëm aty po edhe ma herët plot njerëz, unë s’po pajtohem kur po thojnë, “Jetës time s’ia kisha hjekë ni presje, ni pikë”. Unë i kisha hjekë plot presje, plot pika, plot fjalë, plot fjali, plot periudha, plot faqe me pa mujt ia kisha hjekë. Shyqyr domethonë jo pishmon ato që janë jo ato po do tjera m’i pa pasë gërshanët n’dorë tash i kisha hjekë plot. Kështu që s’po pajtohem me ta që po thojnë, “S’e kisha hjekë ni presje prej jetës time”. Jo valla e kisha hjekë, po s’hiqen.

Anita Susuri: Mirë zoti Ilaz, faleminderit shumë për intervistën, për kohën!

Ilaz Pireva: Nuk di sa kam qenë, i sinqert dine që po, sa kom mbrri m’i shkoqit ajo çashtje pak tjetër.

Anita Susuri: Faleminderit shumë!